



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI DREJTUES**

Nr. 111 prot.

Tiranë, më 29.04.2025

VENDIM

Nr. 1 datë 29.04.2025

**“PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRENDSHME TË AGJENCISË SHQIPTARE
TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE”**

Në mbështetje të shkronjës “c”, të nenit 11, të ligjit nr. 10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve” dhe shkronjës “k” të nenit 14, të Statutit të Agjencisë,

VENDOSI

1. Miratimin e Rregullores së Brendshme të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.
2. Vendimi i AIDA-s, nr. 11, datë 21.07.2011, “Për miratimin e Rregullores, Për Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, shfuqizohet.
3. Ngarkohet administrata e AIDA-s, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDIT DREJTUES

EDI RAMA



MINISTËR, MINISTRIA E FINANCEVE

PETRIT MALAJ

MINISTËR, MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

BLENDI GONXHJA

MINISTËR, MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU

MINISTËR, MINISTRIA E BUJQËSISË

ANILA DENAJ

MINISTËR, MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

MIRELA KUMBARO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI DREJTUES

**RREGULLORE E BRENDSHME PËR ORGANIZIMIN DHE
FUNKSIONIMIN E AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË
INVESTIMEVE**

PËRMBAJTJA

Kreu I-Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Objekti i rregullores	6
Neni 2 Qëllimi	6
Neni 3 Baza Ligjore	6
Neni 4 Misioni	7
Neni 5 Veprimtaria e AIDA-s	7
Neni 6 Fusha e zbatimit	8
Neni 7 Përgjegjësitë e zbatimit të rregullave	8
Neni 8 Parimet kryesore	8

Kreu II-Struktura Organizative dhe Funksionimi i AIDA-s

Neni 9 Strukturat përbërëse të AIDA-s	9
Neni 10 Drejtori Ekzekutiv	10
Neni 11 Drejtoria e Investimeve Strategjike	11
Neni 12 Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit	18
Neni 13 Drejtoria e Projekteve, NVM dhe Eksporteve	23
Neni 14 Drejtoria e Marketingut	29
Neni 15 Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse	34

Kreu III-Marrëdhëniet e Punës

Neni 16 Kriteret e përzgjedhjes së punonjësve	45
Neni 17 Emërimi në detyrë	46
Neni 18 Oraret e punës	47
Neni 19 Etika në punë	47
Neni 20 Rregullat mbi Veprimtaritë e Jashtme	49
Neni 21 Rregullat mbi dhuratat dhe favoret	50
Neni 22 Pushimet	51
Neni 23 Puna në ditët e festave zyrtare	52
Neni 24 Konflikti i interesave	52
Neni 25 Shkeljet dhe Masat disiplinore	52
Neni 26 Llojet e masave disiplinore	55
Neni 27 Largimi nga puna	55
Neni 28 Marrja e detyrës	58
Neni 29 Dorëzimi i detyrës	58

Kreu IV-Marrëdhëniet e Agjencisë me Investitorët

Neni 30 Shprehja e interesit	60
Neni 31 Trajtimi i kërkesës	60

Kreu V-Auditimi dhe Buxheti

Neni 32 Burimet e financimit	61
Neni 33 Buxheti i Agjencisë	61

Neni 34 Raportimi tek Bordi Drejtues	61
Neni 35 Auditimi	62
Kreu VI-Rregulla të Përgjithshme për Organizimin e Punës me Dokumentacionin	
Neni 36 Rregulla të përgjithshme të hyrjes, trajtimit dhe daljes së shkresave në AIDA	62
Neni 37 Organizimi i punës me dokumentacionin në përputhje me etikën e trajtimit të tij	63
Neni 38 Përfaqësimi ligjor i Institucionit në proceset gjyqësore	64
Neni 39 Shërbimet jashtë shtetit	64
Neni 40 Informacioni dhe komunikimi me median	64
Neni 41 Nënshkrimi i dokumentave zyrtare në mungesë të titullarit	65
Neni 42 Hyrja në Institucion	65
Neni 43 Vizitorët	65
Neni 44 Ambienti i punës për administratën	65
Kreu VII-Dispozita të Fundit	
Neni 45 Njohja me Rregulloren	65
Neni 46 Sanksione	66
Neni 47 Ndryshimet në rregullore	66
Neni 48 Parashikime të fundit	67
Neni 49 Hyrja në fuqi	67

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Objekti i rregullores

Rregullorja e brendshme e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (në vijim AIDA), ka për objekt krijimin e një kuadri rregullator, vendos rregullat normative të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e saj, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, rregullat për ushtrimin e funksioneve në mënyrë të kualifikuar si dhe raportet e tyre me strukturat më të larta organizative.

Në të përshkruhen detyrat e çdo Drejtorie, Sektori dhe punonjësi të institucionit dhe procedurat e komunikimit ndërmjet tyre bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të legjislacionit në fuqi.

Neni 2 Qëllimi

Kjo rregullore ka si synim përcaktimin e rregullave mbi:

- a. organizimin e brendshëm dhe funksionimin e AIDA-s;
- b. detyrat funksionale specifike të çdo Drejtorie dhe Sektori të AIDA-s;
- c. mbarëvajtjen dhe disiplinimin e marrëdhënieve të punës dhe të etikës profesionale, si dhe raportet e ndërsjellta ndërmjet drejtorive dhe sektorëve të AIDA-s.
- d. Administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.

Neni 3 Baza Ligjore

1. Rregullorja e brendshme e AIDA-s, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, është një dokument administrativ që hartohet, miratohet dhe ushtron veprimtarinë saj në përputhje me ligjin Nr. 10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, Statutin e saj dhe rregullat e përcaktuara në këtë rregullore.

2. Kjo rregullore del në përputhje dhe mbështetet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurave Administrative; Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); Ligjin nr. 90/2012, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; ligjin nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar; ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; ligji nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve të disa nënpunësve publikë”, i

ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe “Normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”; Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar; ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; Ligjit nr. 9636 datë 06.01.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, (të ndryshuar); ligjit nr. 9131/2003 “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”; Ligj nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, VKM-së nr. 874, datë 29.09.2021 “Për miratimin e rregullave për zbatimin e parimeve të etikës, të klasifikimit të veprimtarive të jashtme dhe vlerën e dhuratave, që mund të pranohen nga gjatë veprimtarisë së nënpunësit të administratës publike”; Udhëzimit nr. 9, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit në Republikën e Shqipërisë”; Udhëzimit nr. 14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në njësitë e qeverisjes qendrore”; Urdhërit Nr. 108, datë 17.11.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Neni 4

Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të politikave të përgjithshme shtetërore ka për mision maksimizimin e investimeve të huaja dhe të brendshme, krijimin e ndërmarrjeve të përbashkëta dhe incentivave ndihmuese për rritjen e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri duke përmirësuar rinovimin e tyre dhe kapacitetet teknologjike me qëllimet e kombinuara që të rrisë investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar për të konkuruar jashtë, të ndihmojë qeverinë në vënien në zbatim të politikave për përmirësimin e klimës dhe infrastrukturës që lidhet me investimet, si dhe të luajë një rol të rëndësishëm në ndërtimin e një imazhi të denjë për Shqipërinë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

Neni 5

Veprimtaria e AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve përqendrohet, në këto drejtime:

- a. lehtësimi dhe mbështetja e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime, duke i ofruar shërbime dhe mbështetje investitorëve ekzistues ose potencialë.
- b. rritja e aftësisë konkurruese të ndërmarrjeve të vogla e të mesme, duke mundësuar rinovimin dhe përmirësimin e produkteve e të shërbimeve, si dhe të teknologjisë që ato përdorin, nëpërmjet ofrimit të mekanizmave që bazohen te rritja e kapaciteteve teknike dhe e aftësive rinovuese.
- c. nxitja dhe ndihma ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse e dhënies së asistencës financiare për shoqëritë eksportuese dhe promovimin e eksporteve.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme për zhvillimin e sektorit privat dhe për përmirësimin e klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, falë ndërmjetësimit dhe bashkëpunimit me subjektet tregtare të huaja dhe me organet shtetërore.

Neni 6

Fusha e zbatimit

Kjo rregullore ka karakter të brendshëm dhe është e detyrueshme për të gjithë administratën e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, duke i shtrirë efektet e saj mbi të gjithë punonjësit e AIDA-s.

Neni 7

Përgjegjësitë e zbatimit të rregullave

Rregullat e brendshme janë të detyrueshme për të gjithë punonjësit e Institucionit, pavarësisht nga funksioni apo struktura në të cilën bëjnë pjesë.

Neni 8

Parimet kryesore

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve bazohet në këto parime:


- a. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit:** të gjithë qytetarët trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht gjinisë, racës, fesë, arsimit, etnisë, gjendjes ekonomike e sociale, bindjeve politike e fetare, etj.
- b. Parimi i ligjshmërisë:** të gjithë punonjësit gjatë ushtrimit të detyrave të tyre për përmbushjen e funksioneve të Institucionit, janë të detyruar të zbatojnë Kushtetutën dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Askujt nuk i lejohet shmangia nga detyrimet ligjore, moszbatimi i ligjit, apo zbatimi i gabuar i tij për shkak të padijenisë së Ligjit.
- c. Parimi i ndalimit të konfliktit të interesave:** asnjë punonjës i Institucionit nuk mund të jetë pjesë e një procesi vendimmarrës, nëse kjo ndalohet nga dispozitat e ligjit nr.44/2015 “Kodit të Procedurave Administrative” dhe ligjit nr. 9367 datë 07.04.2005 “Parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar.
- d. Parimi i mbrojtjes së interesit publik:** administrata e Institucionit “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve”, duhet të veprojë në përmbushje të detyrave të tyre, vetëm në interes të publikut.
- e. Parimi i vazhdimësisë:** detyrat e ndjekura nga punonjësit e mëparshëm, që janë larguar nga detyra, do të vazhdojnë të realizohen nga punonjësit e rinj.
- f. Parimi i transparencës:** administrata e Institucionit “Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve” duhet të jetë sa më transparente për publikun, në të gjitha vendimet apo veprimet që ndërmerr.

g. Parimi i ndershmërisë: të gjithë punonjësit detyrohen të trajtojnë në mënyrë të ndershme dhe të paanshme të gjithë subjektet me të cilët hyjnë në marrëdhënie për shkak të detyrave apo kompetencave të tyre, duke zbatuar me rigorozitet parimet e etikës në administratën publike.

h. Parimi i bashkëpunimit: të gjitha strukturat, punonjësit duhet të sigurojnë bashkëpunimin për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, sipas përcaktimeve të kësaj rregulloreje.

KREU II STUKTURA ORGANIZATIVE DHE FUNKSIONIMI I AIDA-s

Neni 9 Strukturat përbërëse të AIDA-s



Struktura organizative e AIDA-s është:

- 1. Bordi Drejtues;**
- 2. Drejtori Ekzekutiv;**
- 3. Drejtoria e Investimeve Strategjike;**
 - a. Sektori i Monitorimit,
 - b. Sektori One Stop Shop.

4. **Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit;**
 - a. Sektori Lead & Aftercare.
 - b. Sektori Kërkim dhe Zhvillim.
5. **Drejtoria e Projekteve, NVM dhe eksporteve;**
 - a. Sektori Zhvillimit të Projekteve,
 - b. Sektori i NVM dhe Eksporteve.
6. **Drejtoria e Marketingut;**
7. **Drejtoria e Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse;**
 - a. Sektori Financës,
 - b. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse.

Neni 10

Drejtori Ekzekutiv

Me qëllim realizimin e misionit të AIDA-s, në bashkëpunim me autoritetet qendrore dhe lokale, komunitetet e bizneseve, partnerëve vendas dhe të huaj, Drejtori Ekzekutiv punon në drejtim të përmbushjes së objektivave të institucionit:

- a. Drejton dhe administron veprimtarinë e përditshme të AIDA-s, në përputhje me ligjin nr.10303, datë 15.07.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, legjislacionin shqiptar në përgjithësi dhe me statutin e AIDA-s, duke zbatuar vendimet e marra nga Bordi Drejtues.
- b. Vepron në emër të AIDA-s në marrëdhëniet me palë të treta dhe është përgjegjës për ligjshmërinë e veprimtarisë së AIDA-s.
- c. Drejton veprimtarinë e personelit të AIDA-s, përfshirë punësimin, administrimin, kualifikimin e personelit dhe masat disiplinore, në përputhje me ligjin, statutin e Agjencisë dhe rregullat e miratuara nga Bordi Drejtues.
- d. Organizon dhe bashkërendon punën ndërmjet njësive të AIDA-s.
- e. Nxjerr urdhra dhe udhëzime të brendshme të detyrueshme për administrimin administrativ dhe financiar të institucionit.
- f. Emëron dhe shkarkon të gjithë punonjësit e Institucionit sipas strukturës së miratuar;
- g. Emëron, transferon personelin shqyrton dhe miraton propozimet e përcjella për masa disiplinore dhe në rast moszbatimi të detyrës merr masa deri në shkarkimin e tyre;
- h. Nëshkrimin e marrëveshjeve në emër të AIDA-s, me përfaqësues të institucioneve shtetërore të tjera dhe/ose të organizmave ndërkombëtare, përfaqësues të biznesit në kuadër të bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh, bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.
- i. Ngre komisione për zgjedhjen apo ndjekjen e problemeve të ndryshme që shfaqen gjatë veprimtarisë në këtë Institucion.
- j. Kryen delegimin e detyrave mbi çështjet që i drejtohen për trajtim dhe zgjidhje Drejtorëve të Drejtorive sipas afateve të përcaktuara;
- k. Merr vendime dhe miraton materialet e dorëzuara për çështje të cilat tejkalojnë autoritetin vendimmarrës të Drejtorëve të Drejtorive si dhe orienton zgjidhje për çështje që kalojnë autoritetin vendimmarrës të Drejtorëve;

- l. Udhëheq dhe drejton zhvillimin e performancës mbi punën e vartësve të drejtpërdrejtë dhe siguron vlerësim të drejtë për të gjithë punonjësit në Institucion;
- m. Bën vlerësime pune për Drejtorët e Drejtorive;
- n. Lidh kontratat individuale me punonjësit e Institucionit dhe e zgjidh atë në mënyrë të njëanshme, kur nuk plotësohen kushtet e kontratës nga punëmarrësi;
- o. Zgjidh konfliktet midis Drejtorive/Sektorëve dhe siguron etikën profesionale brenda Institucionit;
- p. Harton rregulloren e brendshme të veprimtarisë së AIDA-s dhe ia paraqet për miratim Bordit Drejtues.
- q. Harton dhe i paraqet për miratim Bordit Drejtues, dokumentet financiare dhe programin vjetor të punës së AIDA-s.
- r. Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti i AIDA-s në përputhje me objektivat, qëllimin dhe funksionimin e saj.
- s. Raporton, të paktën, katër herë në vit, para Bordit Drejtues për veprimtarinë e AIDA-s. Me kërkesë të secilit prej anëtarëve të Bordit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv raporton përpara Bordit edhe për çështje specifike, që kanë të bëjnë me veprimtarinë e përditshme të Agjencisë.
- t. Bashkërendon punën me Bordin për zbatimin me sukses të strategjisë së qeverisë për nxitjen e biznesit dhe të investimeve;
- u. Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve të AIDA-s, si dhe bën menaxhimin e tyre.
- v. Krijon dhe zhvillon lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe institucioneve publike, me qëllim realizimin e detyrave dhe të objektivave të Agjencisë, si dhe të përmirësimit, gjithnjë e më tepër, të imazhit pozitiv të Shqipërisë te partnerët e huaj.
- w. Garanton cilësinë e materialeve informuese e promovuese, të bëra nga AIDA, dhe shpërndarjen në kohë të tyre, institucioneve publike dhe private, të interesuara.
- x. I bën propozime dhe sugjerime Bordit Drejtues, në të mirë dhe në interes të veprimtarisë së Agjencisë, sa herë që i kërkohet ose me nismën e vet, përfshirë planin financiar të veprimtarisë e shpenzimet financiare dhe siguron zbatimin e vendimeve të tij.
- y. Ushtron çdo detyrë që nuk i është dhënë Bordit Drejtues apo ndonjë organi tjetër të AIDA-s sipas ligjit, legjislacionit në fuqi dhe statutit të AIDA-s.

Neni 11

Drejtoria e Investimeve Strategjike

11.1 Drejtoria e Investimeve Strategjike është njësi që kryen vlerësim ligjor dhe teknik të dosjes së plotë të investimit, përgatit raportet e vlerësimit, koordinon me të gjitha ministritë, harton projekt-vendimet e KIS, si dhe monitoron planet e veprimit të vendimeve të KIS.

Kjo drejtori përbëhet nga:

11.1.1 Drejtori.

I. Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Investimeve Strategjike:

- a. Drejtori i Drejtorisë së Investimeve Strategjike (IS), përgjigjet tek Drejtori Ekzekutiv për zhvillimin dhe zbatimin e investimeve strategjike në vend dhe është përgjegjës për formulimin dhe zbatimin e strategjive të investimeve në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Agjencisë, si dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga eprori i tij.
- b. Së bashku me Përgjegjësën e Sektorit të Monitorimit hartojnë **“Raportin e Monitorimit Periodik”**, i cili bëhet pjesë e **“Raportit Përmbledhës Vjetor”**, të AIDA-s.
- c. Mbikëqyrja e portofolit të investimeve strategjike të propozuara, duke përfshirë alokimin e aseteve, përzgjedhjen e investimeve dhe menaxhimin e rrezikut.
- d. Monitorimi i performancës së portofolit, vlerësimi i ekspozimit ndaj rrezikut dhe bërja e rregullimeve sipas nevojës për të optimizuar kthimet.
- e. Identifikimi dhe vlerësimi i mundësive të mundshme të investimit, duke përfshirë kapitalin privat, kapitalin sipërmarrës, pasuritë e paluajtshme dhe klasa të tjera të aseteve.
- f. Kryerja e kujdesit të duhur, analizave financiare dhe vlerësimeve të rrezikut për të vlerësuar qëndrueshmërinë dhe kthimet e mundshme të mundësive të investimit.
- g. Negocimi i kushteve, çmimeve dhe strukturave të marrëveshjeve me partnerët e investimeve, sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara.
- h. Bashkëpunimi me ekipet ligjore dhe financiare për të siguruar që marrëveshjet e investimeve janë të strukturuar në mënyrë të përshtatshme dhe në përputhje me objektivat strategjike të vendit.
- i. Komunikimi i strategjive afatmesme dhe afatgjata të investimeve, vendimeve dhe përditësimeve të performancës me drejtuesit e lartë, anëtarët e bordit, investitorët dhe palët e tjera të interesuara.
- j. Ofrimi i raporteve, prezantimeve dhe përditësimeve të rregullta mbi aktivitetet e investimeve dhe performancën e portofolit.
- k. Identifikimi i rreziqeve të mundshme, monitorimi i ekspozimit ndaj rrezikut dhe zbatimi i masave për zbutjen e rrezikut për të mbrojtur interesat e investimit.
- l. Sigurimi i përputhshmërisë me ligjet përkatëse, rregulloret dhe standardet e industrisë që rregullojnë aktivitetet e investimit.
- m. Respektimi i standardeve etike, kërkesave të transparencës dhe përgjegjësi të besueshmërisë në të gjitha vendimet dhe aktivitetet për investime
- n. Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me partnerët e investimeve, institucionet financiare, sipërmarrësit dhe palët e tjera të interesuara.
- o. Kultivimi i një rrjeti kontaktesh për të siguruar mundësi investimi, për të shfrytëzuar ekspertizën dhe për të nxitur bashkëpunimin.
- p. Ndërtimi dhe udhëheqja e një ekipi investimi me performancë të lartë, duke përfshirë punësimin, trajnimin dhe mentorimin e stafit.
- q. Vlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve, metodologjive dhe strategjive të investimit për të përmirësuar performancën e investimit, për të optimizuar kthimet e rregulluara sipas rrezikut dhe për t’iu përshtatur kushteve të ndryshimit të tregut.

- r. Organizon dhe koordinon punën me Përgjegjësin e Sektorit për përpunimin, hartimin dhe ndjekjen e zbatimit të tematikave dhe programeve të punës.
- s. Është përgjegjës për realizimin e detyrave të ngarkuara nga ligji ose nga eprori brenda afatit.
- t. Ndjek dhe merr pjesë në hartimin dhe zbatimin e programit buxhetor afatmesëm dhe të projektbuxhetit vjetor të Drejtorisë që mbulon.
- u. Përgjigjet për disiplinën në punë dhe respektimin e Kodit të Etikës, në strukturën që drejton dhe në bazë të legjislacionit në fuqi brenda kompetencave ligjore, mer masa për çdo punonjës që thyen rregullat.
- v. Organizon mbledhje me stafin në varësi për mbarëvajtjen e punës së Drejtorisë;
- w. Propozon masa administrative për stafin në varësi kur në mënyrë të përsëritur nuk zbatojnë detyrat e ngarkuara dhe kryejnë veprime që janë në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore në fuqi;
- x. Plotëson formularët e Vlerësimit të Performancës për çdo punonjës në varësi dhe i dorëzon pranë Drejtorit të Drejtorisë së Financës, Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse sipas afateve të përcaktuara në Urdhërat e Brendshëm.
- y. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit ekzekutiv që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit.

11.1.2 Sektori i Monitorimit ka si qëllim kryesor të sigurojë që investimet të arrijnë objektivat e tyre dhe të jenë në përputhje me planet e veprimit të miratuara me VKIS. Këtë qëllim ky sektor e realizon duke ndjekur zbatimin e planit të veprimit të vendimeve të KIS, vlerësimin e efektivitetit të investimeve si dhe hartimin dhe ndjekjen e një Dashboardi.

Ky sektor përbëhet nga një përgjegjës dhe tre specialistë.

I. Detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Monitorimit:

- a. Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë të Investimeve Strategjike dhe Drejtori Ekzekutiv në lidhje me sigurimin e monitorimit dhe vlerësimit efektiv të aktiviteteve dhe portofoleve të investimeve;
- b. Ndjek dhe raporton, për çdo projekt të miratuar zbatimin e planit të veprimit të miratuar me Vendim të KIS, duke monitoruar detyrat e lëna si për investitorin ashtu dhe për institucionet.
- c. Hartimin e **Planit të Punës**, lidhur me tërësin e problematikave të çështjeve të ndjekura dhe zbatuara nga institucionet, ku të jenë të pasqyruara të gjitha detyrat si dhe afatet e caktuara.
- d. Hartimin e një **"MEMO"**, çdo 6 muaj lidhur komunikimet të bëra me institucionet, e cila përfshihet në Raportin Përmbledhës Vjetor.
- e. Zhvillimi dhe zbatimi i një kuadri të qartë monitorimi dhe vlerësimi për të gjurmuar performancën dhe ndikimin e aktiviteteve dhe portofoleve të investimeve. Kjo

përfshin përcaktimin e treguesve kyç të performancës (KPI), metrikave dhe standardeve për vlerësimin e rezultateve të investimeve.

- f. Mbikëqyrja e monitorimit të portofoleve të investimeve për të gjurmuar performancën kundrejt objektivave të vendosura, standardeve dhe matjeve të rrezikut.
- g. Monitorimi i rreziqeve të investimit, duke përfshirë faktorëve të mundshëm të rrezikut, vlerësimi i ekspozimit ndaj rrezikut dhe zbatimi i strategjive për zbutjen e rrezikut për të mbrojtur interesat e investimit.
- h. Sigurimi i përputhshmërisë me kërkesat rregullatore, politikat e investimeve dhe kontrollet e brendshme që rregullojnë aktivitetet e investimit.
- i. Kryerja e auditimeve dhe rishikimeve të rregullta për të vlerësuar përputhshmërinë me ligjet, rregulloret dhe standardet përkatëse të industrisë.
- j. Gjenerimi i raporteve të rregullta të performancës dhe përditësimeve mbi aktivitetet e investimeve dhe portofolet për drejtuesit e lartë, anëtarët e bordit, investitorët dhe palët e tjera të interesuara.
- k. Komunikimi efektiv i performancës së investimeve, tendencave dhe njohurive përmes raporteve, prezantimeve dhe paneleve.
- l. Identifikimi i mundësive për optimizimin e portofolit, rregullimet e shpërndarjes së aseteve dhe rialokimet strategjike bazuar në analizën e të dhënave.
- m. Organizimi dhe lehtësimi i takimeve të rishikimit të investimeve për të diskutuar performancën e portofolit, strategjitë e investimeve dhe iniciativat e menaxhimit të rrezikut.
- n. Identifikimi i zonave për optimizimin e procesit, automatizimin dhe inovacionin për të thjeshtuar aktivitetet e monitorimit.
- o. Bashkëpunimi me ekipet e investimeve, ekipet e menaxhimit të rrezikut, palët e tjera të interesuara për të siguruar përafrimin dhe koordinimin në përpjekjet e monitorimit dhe vlerësimit, palët e interesuara të brendshme dhe të jashtme për të lehtësuar shkëmbimin dhe bashkëpunimin e informacionit.
- p. Merr masa organizative për plotësimin e detyrave nga çdo punonjës në veçanti, për ndjekjen dhe zbatimin e projekteve të miratuara për subjektet që kanë përfituar statusin investim/investitor strategjik, brenda planifikimit të detyrave dhe planit të punës së miratuar të Drejtorisë së Investimeve Strategjike;
- q. Kontrollon punën e përditshme të specialistëve në varësi për plotësimin e detyrave që i janë ngarkuar;
- r. Propozon marrjen e masave disiplinore për punonjësit e varësisë;
- s. Zhvillon marrëdhënie bashkëpunimi me sektorë të tjerë të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve;
- t. Organizon sistemin e administrimit të informacionit dhe të statistikave për veprimtarinë e sektorit;
- u. Zbaton procedurat dhe afatet në përmbushjen e detyrave, si dhe raporton për punën e kryer përpara Drejtorit të Drejtorisë së Investimeve Strategjike;
- v. Kontribuon në përgatitjen e materialeve të ndryshme, në lidhje me veprimtarinë e sektorit që përfaqëson dhe merr pjesë në grupe të ndryshme pune, komisione dhe borde, me miratim paraprak;

- w. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit.

II.Detyrat e specialistit të Sektorit të Monitorimit:

- a. Specialisti i Sektorit të Monitorimit përgjigjet te përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit, Drejtori i Drejtorisë të Investimeve Strategjike dhe Drejtori Ekzekutiv në lidhje me punën që ka kryer në sigurimin e monitorimit dhe vlerësimit efektiv të aktiviteteve dhe portofoleve të investimeve, dhe në sigurimin e transparencës, llogaridhënies dhe performancës së aktiviteteve investuese brenda sektorit.
- b. Mbledhja e të dhënave përkatëse mbi aktivitetet investuese, duke përfshirë mbledhjen e të dhënave nga sistemet e brendshme, burimet e jashtme dhe raportet e investimeve.
- c. Analizimi i të dhënave të investimeve për të vlerësuar performancën e portofolit, ekspozimin ndaj rrezikut dhe pajtueshmërinë me udhëzimet e investimeve;
- d. Ndjekja e performancës së portofoleve të investimeve kundrejt standardeve, objektivave dhe KPI-ve të vendosura.
- e. Monitorimi i treguesve kryesorë të performancës si kthimet, paqëndrueshmëria dhe tërheqjet për të vlerësuar shëndetin e portofolit.
- f. Monitorimi i rreziqeve të investimit, duke përfshirë identifikimin e faktorëve të mundshëm të rrezikut, vlerësimi i ekspozimit ndaj rrezikut.
- g. Monitorimi i përputhshmërisë me kërkesat rregullatore, politikat e investimeve dhe kontrollat e brendshme që rregullojnë aktivitetet e investimit.
- h. Gjenerimi i raporteve dhe përditësimeve të rregullta mbi performancën e investimeve, matjet e rrezikut dhe statusin e pajtueshmërisë.
- i. Pjesëmarrja në takimet e rishikimit të investimeve për të diskutuar performancën e portofolit, strategjitë e investimeve dhe iniciativat e menaxhimit të rrezikut;
- j. Sigurimi i të dhënave dhe analizave për të mbështetur proceset e vendimmarrjes gjatë këtyre takimeve.
- k. Kontribuimi në përmirësimin e proceseve, metodologjive dhe mjeteve të monitorimit dhe vlerësimit.
- l. Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve efektive për të lehtësuar bashkëpunimin dhe koordinimin në përpjekjet monitoruese.
- m. Pjesëmarrja në aktivitete trajnimi dhe zhvillimi për të rritur njohuritë dhe aftësitë në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e investimeve.
- n. Realizon detyrat bazë të ndarjes së brendshme të tyre nga Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit;
- o. Trajton dhe zgjidh brenda kuadrit të kompetencave, kërkesat apo ankesat e paraqitura që i delegohen nga Përgjegjësi i Sektorit të Monitorimit;
- p. Kontrollon zbatimin e legjislacionit në fuqi për çështjet që i propozohen;

- q. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë dhe Përgjegjës të Sektorit që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit.

11.1.3 Sektori i One Stop Shop.

Ky sektor përbëhet nga një përgjegjës dhe katër specialistë.

I.Detyrat e Përgjegjës të Sektorit të One Stop Shop:

- a. Përgjegjësi i Sektorit të One Stop Shop përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë të Investimeve Strategjike dhe Drejtori Ekzekutiv për sa i përket punës së tij në thjeshtimin dhe lehtësimin e procesit të investimit për investorët e mundshëm, si dhe rolin që ka në tërheqjen e investimeve, nxitjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrencës në investime.
- b. Shërben si pika kryesore e kontaktit për investorët e mundshëm, duke ofruar udhëzime, informacione dhe ndihmë gjatë gjithë procesit të investimit;
- c. Siguron komunikim të shpejtë dhe efektiv për të adresuar pyetjet dhe shqetësimet e investorëve potencial.
- d. Projekton dhe zbaton proceseve të thjeshtuara dhe të përshpejtuar lidhur me proceset e investimit për investorët e mundshëm. Kjo përfshin identifikimin e pengesave, reduktimin e dokumentacionit dhe rritjen e efikasitetit në trajtimin e kërkesave për investime.
- e. Lehtëson procesin e investimit për investorët potencialë nga kërkesa fillestare deri në vendimin përfundimtar të investimit. Kjo mund të përfshijë koordinimin me sektorët e brendshëm, agjencitë qeveritare dhe partnerët e jashtëm për të ofruar mbështetje dhe ndihmë gjithëpërfshirëse.
- f. Siguron informacionin përkatës për investorët mbi mundësitë e investimit, kushtet e tregut, kërkesat rregullatore dhe stimujt për investime;
- g. Siguron që investorët të kenë akses në informacione të sakta dhe të përditësuara për të marrë vendime të informuara.
- h. Ofron shërbime mbështetëse për investorët, duke përfshirë asistencën me aplikimet për leje, kërkesat për licencim, blerjen e tokës dhe procedura të tjera administrative.
- i. Ofron i udhëzimeve dhe referimeve për palët përkatëse të interesuara sipas nevojës;
- j. Mban marrëdhënie me investorët, shoqatat e industrisë, dhomat e tregtisë, agjencitë qeveritare dhe palët e tjera të interesit.
- k. Kultivon partneritete dhe mundësi të bashkëpunimit për të përmirësuar mjedisin e investimeve dhe për të tërhequr investime.
- l. Monitoron performancën dhe efektivitetin e shërbimit one-stop-shop në tërheqjen dhe lehtësimin e investimeve. Ndjek treguesit kryesorë të performancës si kënaqësia e investorëve, koha e përgjigjes dhe angazhimet për investime.
- m. Vlerëson dhe përmirëson në vazhdimësi shërbimet me një ndalesë për të rritur përvojën dhe kënaqësinë e investorëve, dhe jep zgjidhje të procesit, zgjidhjeve teknologjike dhe praktikave më të mira për të përmirësuar operacionet dhe për të ofruar vlerë për investorët.

- n. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit

II. Detyrat e specialistit të Sektorit të One Stop Shop:

- a. Specialisti në Sektorin One Stop Shop raporton te Përgjegjësi i Sektorit të One Stop Shop Drejtori i Drejtorisë të Investimeve Strategjike dhe Drejtori Ekzekutiv në lidhje me detyrën e tij e të ofruarit mbështetje dhe ndihmë të specializuar për investitorët e mundshëm gjatë gjithë procesit të investimit.
- b. Shërben si pikë kontakti për investitorët potencialë, duke ofruar udhëzime, informacione dhe asistencë në lundrimin e procesit të investimit, dhe adresimin e pyetjeve, shqetësimeve dhe kërkesave të investitorëve në një mënyrë të shpejtë dhe profesionale.
- c. Mbikëqyr aplikimet për marrje statusi investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar/e veçantë.
- d. Harton raportet për Komitetin e Investimeve Strategjike (KIS).
- e. Sigurimin me informacionin përkatës investitorët mbi mundësitë e investimit, kushtet e tregut, kërkesat rregullatore dhe stimujt për investime.
- f. Sigurimin që investitorët të kenë akses në informacione të sakta dhe të përditësuara për të marrë vendime të informuara.
- g. Ndihmon investitorët me përgatitjen dhe dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar, aplikimeve për leje dhe kërkesave të tjera administrative. Siguron që të gjitha dokumentet e nevojshme të plotësohen me saktësi dhe në kohën e duhur.
- h. Koordinon me departamentet e brendshme, agjencitë qeveritare dhe partnerët e jashtëm për të lehtësuar procesin e investimit dhe ndërlidhet me palët përkatëse të interesit për të siguruar komunikim të qetë dhe bashkëpunim në adresimin e nevojave të investitorëve.
- i. Mbështet aktivitetet e promovimit të investimeve për të tërhequr investitorë potencialë dhe për të promovuar mundësitë e investimit.
- j. merr pjesë në ngjarjet në terren, panairët tregtare dhe aktivitetet e rrjetëzimit për të shfaqur ofertat dhe aftësitë e organizatës.
- k. Ndërton dhe mban marrëdhënie me investitorët, shoqatat e industrisë, dhomat e tregtisë dhe palët e tjera të interesit.
- l. Nxit partneritete dhe mundësi bashkëpunimi për të përmirësuar mjedisin e investimeve dhe për të tërhequr investime.
- m. Mbledh sugjerime apo komente nga investitorët mbi përvojën e tyre me procesin e investimit dhe shërbimin me një ndalesë, dëgjimin e shqetësimeve, sugjerimeve dhe preferencave të investitorëve për të identifikuar fushat për përmirësim dhe përmirësim.
- n. Mban të dhëna të sakta të ndërveprimeve, pyetjeve dhe kërkesave të investitorëve. Përpilon të dhëna dhe gjeneron raporte mbi aktivitetin e investitorëve, kohën e përgjigjes dhe nivelet e kënaqësisë për të gjurmuar performancën dhe për të informuar vendimmarrjen.

- o. Merr pjese në trajnime dhe aktivitete të ngritjes së kapaciteteve për të rritur njohuritë dhe aftësitë që lidhen me lehtësimin e investimeve, shërbimin ndaj klientit dhe marrëdhëniet me investitorët.
- p. Informohet për tendencat e industrisë, praktikat më të mira dhe ndryshimet rregullatore që ndikojnë në proceset e investimeve.
- q. Kontribuon në përmirësimin e vazhdueshëm të shërbimit me një ndalesë duke propozuar përmirësime të procesit, zgjidhje teknologjike dhe praktika më të mira.
- r. Bashkëpunon me anëtarët e ekipit për të zbatuar përmirësime që thjeshtojnë operacionet.
- s. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë, Përgjegjësit të Sektorit që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit

Neni 12

Drejtoria e Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit

12.1 Drejtoria e Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit përbëhet nga:

12.1.1 Drejtori i Drejtorisë.

I. Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së Investimeve të Huaja, Partneritetit dhe Kërkimit:

- a. Drejtori i Drejtorisë së Investimeve të Huaja Direkte, Partneritetit dhe Kërkimit përgjigjet tek Drejtori Ekzekutiv për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive për tërheqjen e IHD-ve në vend ose rajon, identifikimin e mundësive potenciale të investimit dhe kryerjen e hulumtimit të tregut për të vlerësuar qëndrueshmërinë e tyre.
- b. Ndërtimi dhe mbajtja e marrëdhënieve me investitorët e huaj, zyrtarët e qeverisë dhe palët e tjera të interesuara.
- c. Ofrimi i ndihmës dhe mbështetjes për investitorët e huaj gjatë gjithë procesit të investimit, duke përfshirë zhvillimin/zgjerimin e kërkesave rregullatore dhe sigurimin e lejeve të nevojshme.
- d. Negocimi i marrëveshjeve të investimeve, stimujve dhe kushteve të tjera me investitorët e huaj për të maksimizuar përfitimet për vendin.
- e. Monitorimi dhe vlerësimi i flukseve hyrëse të IHD-ve dhe ndikimi i tyre në ekonominë.
- f. Bashkëpunimi me departamente ose agjenci të tjera për të promovuar politika dhe rregullore miqësore lidhur me investimet.
- g. Përfaqësimi i organizatës ose qeverisë në forume dhe negociata ndërkombëtare në lidhje me IHD.
- h. Zhvillimi dhe menaxhimi i ngjarjeve të promovimit të investimeve, të tilla si konferenca, seminare, forume biznesi dhe misione tregtare, për të shfaqur mundësitë e investimeve.
- i. Analizimi i tendencave në investimet globale dhe identifikimi i mundësive ose sfidave në zhvillim.

- j. Monitorimi dhe analizimi i tendencave ekonomike dhe gjeopolitike globale që mund të ndikojnë në hyrjet e IHD-ve dhe këshillimi për strategjitë e duhura të reagimit.
- k. Ofrimi i këshillave dhe udhëzimeve për menaxhmentin e lartë ose zyrtarët e qeverisë për çështje të lidhura me IHD.
- l. Bashkëpunimi me institucionet akademike dhe organizatat kërkimore për të promovuar inovacionin dhe transferimin e teknologjisë si pjesë e nismave të IHD-ve.
- m. Lehtësimi i partneriteteve dhe bashkëpunimeve ndërmjet investorëve të huaj dhe bizneseve apo industrive vendase për të nxitur shkëmbimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve.
- n. Avokimi për reforma në politika dhe rregullore për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të tërhequr më shumë IHD.
- o. Kryerja e aktiviteteve informuese dhe angazhimi për të rritur ndërgjegjësimin për përfitimet e IHD-ve dhe për të larguar keqkuptimet ose shqetësimet.
- p. Pjesëmarrja në rrjetet dhe iniciativat ndërkombëtare të promovimit të investimeve për shkëmbimin e praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit në tërheqjen e IHD-ve.
- q. Zhvillimi i materialeve promovuese dhe fushatave për të shfaqur mundësitë e investimeve.
- r. Orienton dhe u propozon investorëve mbi pronën më optimale të mundshme për alokimin e investimit të tyre.
- s. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit.

12.1.2 Sektori Lead & Aftercare.

Ky sektor përbehet nga një përgjegjës dhe katër specialistë.

I. Detyrat e përgjegjësit të Sektorit Lead & Aftercare:

- a. Përgjegjësi i Sektorit të Lead & Aftercare, përgjigjet te Drejtori i Drejtorisë të IHD, Partneritetit dhe Kërkimit dhe Drejtori Ekzekutiv, në lidhje me rolin e tij në menaxhimin e procesit të tërheqjes dhe mbajtjes së investimeve dhe investorëve të mundshëm, në nxitjen e rritjes ekonomike dhe rritjen e konkurrencës së vendit në tregun global ofrimin e mbështetjes dhe asistencës së vazhdueshme për investorët pas investimit.
- b. Ndjek progresin e projekteve investuese, monitorimi i performancës dhe ndikimit të tyre në ekonominë lokale dhe vlerësimi i efektivitetit të Lead Generation dhe strategjive të shërbimeve të përkujdesjes ndaj investorëve ekzistues.
- c. Shërben si pika kryesore e kontaktit për investorët, duke adresuar kërkesat, komentet e tyre në kohën e duhur dhe në menyrë profesionale për të mbajtur marrëdhënie pozitive dhe për të rritur kënaqësinë e investorëve.
- d. Bashkëpunon me agjencitë qeveritare, shoqatat e industrisë, organizatat e zhvillimit ekonomik dhe palët e tjera të interesuara për të koordinuar përpjekjet për Lead Generation dhe Aftercare dhe për të shfrytëzuar burimet dhe ekspertizën.
- e. Zhvillon strategji dhe iniciativa për të identifikuar dhe gjeneruar drejtime për investorët e mundshëm, duke përfshirë korporatat shumëkombëshe, firmat e kapitalit sipërmarrës dhe subjektet e tjera të interesuara për të investuar në vendin ose rajonin pritës.

- f. Kultivon marrëdhënie me drejtuesit përmes kontaktit të synuar, ngjarjeve të rrjetëzimit dhe komunikimit të personalizuar për të kuptuar nevojat dhe preferencat e tyre për investime
- g. Zhvillon strategji dhe procese për të kthyer investitorët potencialë në investitorë të përkushtuar, duke përfshirë sigurimin e informacionit, lehtësimin e vizitave në terren dhe adresimin e çdo shqetësimi ose pengese që mund të hasin.
- h. Krijon dhe mbikëqyr shërbimet e përkujdesjes për të ofruar mbështetje dhe ndihmë të vazhdueshme për investitorët pas investimit, duke përfshirë hulumtimin mbi kërkesat rregullatore, aksesin në incentiva dhe zgjidhjen e çështjeve operationale.
- i. Siguron të dhëna dhe rekomandime për politikëbërësit mbi politikën, rregulloret dhe incentivat për të përmirësuar klimën e investimeve, për të adresuar shqetësimet e investitorëve dhe për të rritur atraktivitetin e vendit ose rajonit pritës për investime.
- j. Zhvillon programe të trajnimit, seminare dhe nisma për ndarjen e njohurive për të ndërtuar kapacitetin e stafit dhe palëve të interesuara të përfshira në gjenerimin e projekteve potenciale të investimit dhe aktivitetet e shërbimeve të përkujdesjes.
- k. Përpilon dhe analizon të dhëna, përgatit raporte dhe mban dokumentacion në lidhje me Lead Generation, kërkesat e investitorëve, projektet e investimeve dhe shërbimet e përkujdesjes për përdorim të brendshëm dhe qëllime raportimi.
- l. Krijon dhe nxit fushata të marketingut, materialeve promovuese dhe ngjarjeve për të shfaqur mundësitë e investimeve dhe për të tërhequr investitorë potencialë në vendin ose rajonin pritës.
- m. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit

II.Detyrat specialistit të Sektorit Lead & Aftercare:

- a. Specialisti i Sektorit Lead & Aftercare përgjigjet te Përgjegjësi i Sektorit të Lead & Aftercare, Drejtori i Drejtorisë të IHD, Partneritetit dhe Kërkimit dhe Drejtori Ekzekutiv për sa i takon në rolin e tij në tërheqjen e investitorëve të mundshëm dhe ofrimin e mbështetjes së vazhdueshme për investitorët pas investimit.
- b. Mbledh dhe përpunon informacion, në kuadër të identifikimit/targetimit të investitorëve të synuar në sektorët strategjikë, si dhe asiston në përcaktimin e grupeve të targetuara;
- c. Kontribuon në krijimin dhe mirëmbajtjen e një baze të dhënash të kompanive të targetuara/asistuar/prezente ndërkombëtare me të dhënat e nevojshme të profilit të kompanisë.
- d. Vendos komunikime me grupet e targetuara, për t'i inkurajuar ato për të investuar në Shqipëri.
- e. Vendos dhe mban komunikime me të gjithë aktorët kryesorë si, ambasadat, dhomat bilaterale të tregtisë, komunitetin e diasporës, organizata të ndryshme me fokus në investime dhe agjenci simotra në rajon dhe botë.
- f. Kontribuon në drejtim të zhvillimit të fushatave promociionale, B2B, misionëve tregtare, panairove ndërkombëtare për targetimin e investimeve, me qëllim promovimin e avantazheve që ofron Shqipëria për investitorët potencialë, krahasuar këto me vendet e rajonit.

- g. Kontribuon në realizimin e publikimeve dhe kërkimeve për sektorët prioritarë.
- h. Kontribuon në identifikimin e investitorëve të huaj sipas sektorëve strategjik të vendit.
- i. Kontribuon në hartimin e strategjisë për përkujdesjen ndaj investitorëve të huaj në vend, identifikimin e problematikave të mundshme dhe adresimin e tyre të institucionet kompetente për zgjidhjen e tyre.
- j. Harton iniciativa me interes për investitorët e huaj dhe ata ekzistues.
- k. Identifikon evente apo ngjarje të rëndësishme që lidhen direkt me fokusin e drejtorisë.
- l. Drafton MOU dhe ndjek nënshkrimin e tyre me palët apo institucionet e interesuara.
- m. Mban kontakte me institucionet kryesore të cilët furnizojnë me të dhëna sipas fokusit të drejtorisë, konkretisht, INSTAT, QKB, Drejtoria e Tatimeve dhe Doganave, si dhe BSH.
- n. Ofron udhëzime dhe mbështetje për investitorët e huaj për kërkesat rregullore, mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe konsiderata të tjera ligjore që lidhen me investimet.
- o. Kontribuon në drejtim të përditësimit në mënyrë të vazhdueshme të materialeve promovuese.
- p. Zbaton çdo urdhër tjetër apo detyrë (verbal ose shkresor) të Drejtorit Ekzekutiv, Drejtorit të Drejtorisë, Përgjegjësit të Sektorit që nuk përfshihet në pikat më lartë (që nuk përbëjnë shkelje ligjore), pa cënuar dinjitetin e punonjësit

12.1.3 Sektori Kërkim dhe Zhvillim.

Ky sektor përbëhet nga një përgjegjës dhe tre specialistë.

I. Detyrat e përgjegjësit të Sektorit të Kërkim dhe Zhvillimit:

